



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER LORIANA A. ROBO  
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,  
NR.27, NR.1, NR.1  
TEL: 694070762

## VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 587

Nr. koleksioni: 81

Tirane më 02/02/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022050250010515919

DATE 02/02/2022

NR REP 587

NR KOL 81



A2022050250010515919

## VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, më datë 02.02.2022, para meje Noterit LORIANA A. ROBO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

### KËRKUESI:

**Jonida Skëndaj**, atësia Marsel, amësia Vera, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Sheh Ahmet Pazari; Nd. 4; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 26/02/1980, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037525659 dhe nr. personal I052261551.

### OBJEKTI:

Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Marsel (Zagoll) Skëndaj**.

### BAZA LIGJORE:

Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Unë Noteri, pasi administrova provat shkresore,

### V Ë R E J:

Se kërkuesi, Jonida Skëndaj, ka depozituar më datë 27.01.2022, në këtë zyrë noteriale, një kërkesë me anë të së cilës kërkohet: "Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin Marsel (Zagoll) Skëndaj".

Nga dokumentet e depozituar nga kërkuesi me dosjen sipas kërkesës për lëshimin e trashëgimisë ligjore për të ndjerin Marsel (Zagoll) Skëndaj, të administruara nga unë noteri, rezultoi e provuar se:

- Trashëgimlënësi Marsel Skëndaj, shtetas shqiptar, i biri i Zagoll dhe Lushe, lindur më 06.11.1949, në Rexhi, Tepelenë, me numër personal E91106064L, me banim të regjistruar në Sheh Ahmet Pazari, Nd. 4, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1010, Tiranë, ka ndërruar jetë më datë 14.11.2021, në Frankfurt am Main, Gjermani.
- Trashëgimlënësi nuk rezulton të ketë lënë testament. Ky fakt vertetohet edhe nga verifikimi i bërë nga unë Noteri, në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve pranë Dhomës Kombëtare të Noterëve përmes kthim përgjigje datë 02.02.2022.
- Trashëgimlënësi Marsel (Zagoll) Skëndaj ka qënë i martuar me Vera Skëndaj, e bija e Osman dhe Nekije, e lindur më 30.05.1950, në Tiranë, me nr. personal F05530024T. Nga martesë e tyre kanë lindur 3 (tre) fëmijë, si më poshtë:

(i) **Jonida Skëndaj**, e bija e Marsel dhe Vera, e datëlindjes 26.02.1980, lindur në Tiranë, me banesë të regjistruar në Sheh Ahmet Pazari, Nd. 4, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1010, Tirane, me nr. personal I052261551,



A2022050250010513919

(ii) **Gjergj Skëndaj**, i biri i Marsel dhe Vera, i datëlindjes 29.08.1981, lindur në Tiranë, me banesë të regjistruar në Sheh Ahmet Pazari, Nd. 4, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1010, Tirane, me nr. personal I10829047J, dhe

(iii) **Anisa Skëndaj**, e bija e Marsel dhe Vera, e datëlindjes 17.12.1984, lindur në Tiranë, me banesë të regjistruar në Dervish Hima, Nd. 4, H. 3/1, Njesia Administrative Nr. 2, Njesia Bashkiake Nr. 2, 1003, Tirane, me nr. personal I41217090I.

Sa më sipër provohet nga dokumentet në vijim:

- a. Çertifikatë vdekje e Marsel Skëndaj, nr. 017866047, datë 27.01.2022, lëshuar nga Bashkia Tiranë, Njesia administrative Tirane Nr. 2 374, në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;
- b. Çertifikatë martesë të Marsel Skëndaj dhe Vera Skëndaj, nr. 017279047, datë 19.11.2021, lëshuar nga Qarku Tirane, Rrethi Tirane, Zyra e gjendjes civile (Arkiva), Bashkia Tirane, në bazë të Librit/Akteve të martesës, Akt martesë nr. 21 ZGJC L 3 Tirane, të vitit 1979;
- c. Çertifikatë familjare të Marsel Skëndaj, nr. 017866046, datë 27.01.2022, nga Bashkia Tirane, Njesia Administrative Nr. 2 374, Zyra e gjendjes civile 374, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- d. Çertifikatë familjare të Marsel Skëndaj, nr. 017403479, datë 28.01.2022, nga Bashkia Tirane, Njesia Administrative Nr. 8 380, Zyra e gjendjes civile 380, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- e. Çertifikatë familjare të Marsel Skëndaj, nr. 000942201, nxjerrë elektronikisht nga *e-Albania* më datë 29.09.2021, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- f. Çertifikatë familjare të Vera Skëndaj, nr. 000942201, nxjerrë elektronikisht nga *e-Albania* më datë 01.02.2022, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- g. Çertifikatë personale të Vera Skëndaj, nr. 0002676646, nxjerrë elektronikisht nga *e-Albania* më datë 01.02.2022, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- h. Çertifikatë personale të Jonida Skëndaj, nr. 000267646, nxjerrë elektronikisht nga *e-Albania* më datë 01.02.2022, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- i. Çertifikatë personale të Gjergj Skëndaj, nr. 000267646, nxjerrë elektronikisht nga *e-Albania* më datë 01.02.2022, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- j. Çertifikatë personale të Anisa Skëndaj, nr. 000267646, nxjerrë elektronikisht nga *e-Albania* më datë 01.02.2022, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;

Në përputhje me përcaktimet e nenit 348 të Kodit Civil, unë noteri konstatoj se trashëgimlënësi, i ndjeri Marsel (Zagoll) Skëndaj, ka pasur vendbanimin e regjistruar në datën e vdekjes në adresën: Sheh Ahmet Pazari, Nd. 4, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1010, Tiranë. Bazuar në sa më sipër dhe në përcaktimet e nenit 111, germa a) të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, konstatoj se çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore në fjalë është në kompetencën time vendore.

Në bazë të nenit 318 të Kodit Civil, i cili parashikon se “trashëgimia çelet në kohën kur vdes trashëgimlënësi dhe në vendin ku ka pasur banimin e tij të fundit... Ajo rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur”, përcakton se në rastin në fjalë koha kur çelet trashëgimia është data e vdekjes e të ndjerit Marsel (Zagoll) Skëndaj dhe pikërisht data 14.11.2021. Prandaj ligji që do të parashikojë rregullimin ligjor për çeljen e trashëgimisë së tij do të jetë ligji në fuqi në atë datë dhe pikërisht Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë në fuqi, miratuar me Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar (në këtë dokument referuar si “Kodi Civil”).

Në bazë të nenit 317 të Kodit Civil të sipërpërmëndur “trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament...”. Në rastin në fjalë, meqënëse trashëgimlënësi Marsel



A2022050250010513919

Skëndaj nuk ka bërë testament, për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë do të zbatohen dispozitat ligjore të Kodit Civil që rregullojnë trashëgiminë ligjore.

Duhet theksuar se, që trashëgimtarët ligjorë të përfitojnë nga pasuria trashëgimore duhet së pari që ata të kenë zotësi trashëgimore dhe së dyti të bëjnë pjesë në radhën e trashëgimtarëve ligjorë që në bazë të ligjit u takon pasuria trashëgimore.

Përsa i përket pikës së parë, në bazë të nenit 320 të Kodit Civil, zotësi për të trashëguar *“ka personi qe ne kohen e çeljes së trashegimise, pra kur ka vdekur trashegimlensesi, eshte gjalle...”*

Përsa i përket pikës së dytë, neni 360 i Kodit Civil, parashikon se *“trashegimtare ligjore jane femijet, femijet e femijeve, bashkeshorti, prinderit,.... Keta thirren ne trashegimi sipas radhes se caktuar ne kete Kod.”*

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme ligjore të Kodit Civil rezulton se kur çelet trashëgimia ligjore e së ndjerit, në radhë të parë përfitojnë bashkëshorti dhe fëmijët e trashëgimlënësit, të cilët janë gjallë në çastin e çeljes së trashëgimisë, në pjesë të barabarta ideale secili.

Përsa më sipër në rastin në fjalë, trashëgimtarë të trashëgimlënësit Marsel (Zagoll) Skëndaj, i cili ka ndërruar jetë me gjendjen civile “i martuar”, janë bashkëshortja e tij Vera Skëndaj dhe tre fëmijët e tyre: Jonida Skëndaj, Gjergj Skëndaj dhe Anisa Skëndaj, të cilët janë të gjithë gjallë në kohën e çeljes së trashëgimisë. Ata janë trashëgimtare ligjorë të rradhës së parë dhe trashëgojnë të gjithë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit në pjesë të barabarta idele.

Kërkuesi Jonida Skëndaj deklaroi se asnjë prej trashëgimtarëve nuk ka hequr dorë apo është bërë i padenjë për të trashëguar trashëgimlënësin, të ndjerin Marsel (Zagoll) Skëndaj.

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të neneve 348 e në vijim të Kodit Civil dhe Neneve 111 e vijues të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, unë Noteri,

### VENDOS:

1. Pranimin e kërkesës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Marsel Skëndaj**, shtetas shqiptar, i biri i Zagoll dhe Lushe, lindur më 06.11.1949, në Rexhi, Tepelenë, me numer personal E91106064L, me banim të regjistruar në Sheh Ahmet Pazari, Nd. 4, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1010, Tiranë.

2. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Marsel (Zagoll) Skëndaj, e cila çelet në datën e vdekjes së tij, pra më datë 14 Nëntor 2021.

3. Përcaktimin si trashëgimtarë ligjorë të rradhës së parë me të gjithë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit (me nga një të katërtën (1/4) pjesë ideale secili), personat e mëposhtëm:

**i. Vera Skëndaj**, e bija e Osman dhe Nekije, e lindur më 30.05.1950, në Tiranë, me nr. personal F05530024T (bashkëshortja – trashëgimtare me 1/4 pjesë ideale);

**ii. Jonida Skëndaj**, e bija Marsel dhe Vera, e datëlindjes 26.02.1980, lindur në Tiranë, me nr. personal I05226155I (e bija – trashëgimtare me 1/4 pjesë ideale);

**iii. Gjergj Skëndaj**, i biri i Marsel dhe Vera, i datëlindjes 29.08.1981, lindur në Tiranë, me nr. personal I10829047J (i biri – trashëgimtar me 1/4 pjesë ideale); dhe



A2022050250010515919

**iv. Anisa Skëndaj**, e bija Marsel dhe Vera, e datëlindjes 17.12.1984, lindur në Tiranë, me nr. personal I41217090I (e bija – trashëgimtare me 1/4 pjesë ideale).

4. Kërkuesi i këtij akti, brenda 30 ditëve nga lëshimi i kësaj dëshmie, duhet të depozitojë në institucionin përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, një kopje të dëshmisë së trashëgimisë, nëse është rasti, në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

5. Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të çënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 “Për Noterinë”.

6. Kjo Dëshmi Trashëgimie Ligjore lëshohet sot, në Tiranë, më datë 02.02.2022.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.



**NOTER**  
**Loriana A. ROBO**

TAKSA E PULLËS  
E PAGUAR  
Noter Lorian A. Robo